

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“RECRUIT PLUS” SH.P.K**

**NENI 1**  
**FORMIMI**

Sot, më datë 21.06.2022 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “RECRUIT PLUS” Sh.p.k themelohet në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”. Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Z.Eljo HYSKO**, i biri i Katriot dhe Elida, datëlindje 29.01.1993, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, në Adresën Rr.”Margarita Tutulani”, Nd.10, Shk.1, H 1, Tiranë, identifikuar me ID me Nr. 037020874 dhe Nr. Personal J30129060S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. **Znj. Bardha DYRMISHI** e bija e Ethem dhe Barie, e datëlindjes 27.07.1955, lindur në Melind dhe banuese në Tiranë, në Adresën Rr: “Nikolla Tupe”,identifikuar me ID me Nr. 034079992 dhe Nr. Personal F55727027Q, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Organi administrues i Shoqërisë ka të drejtë të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “RECRUIT PLUS” Sh.p.k është në adresën: ***Rruga “Margarita Tutulani”, Nd.10, Shk.1, H 1, Tiranë, Shqipëri.***

Ortakët mund të vendosin për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër.

**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “RECRUIT PLUS” Sh.p.k është e pacaktuar.

**NENI 4**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “RECRUIT PLUSn” Sh.p.k. do të jetë:

- 1- Aktivitet në fushën e konsulencës dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore.
- 2- Menaxhim strategjik në fushën e burimeve njerëzore.
- 3- Shërbime të këshllimit dhe rekrutimit në këtë fushë.
- 4- Politikat e burimeve njerëzore.
- 5- Zhvillimi i procedurave të burimeve njerëzore.

- 6- Trajnimi dhe zhvillimi.
- 7- Proçes i plotë rekrutimi punonjësish.
- 8- Shoqëria do të japë konsulencë biznesi në fushën e investimeve financiare, ndërmjetësim ligjor për kompani dhe individë që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 9- Ndërmjetësim të përgjithshëm për kompani dhe individë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 10- Konsulenca për strukturim ose ristrukturim, planifikim dhe zhvillim të mënyrës së organizimit të kompanive.
- 11- Shërbim përfaqësimi ndaj shoqërive tregtare, individëve dhe tregtareve, qofshin këta vendas apo të huaj.
- 12- Konsulencë për investime dhe zhvillim në fushën e Hoteleri Turizëm.
- 13- Aktivitet agjencie dhe agjenti. Rekrutim.
- 14- Vlerësimi dhe përpilimin e kontratave të kompanive para apo gjatë lidhjes së marrëveshjeve.
- 15- Shërbimin e ndërmjetësimit në punësim. Informim për vendet e lira të punës. Ndërmjetësim për punësim.
- 16- Këshillim dhe orientim për punë dhe profesion. Informacion dhe këshillim.
- 17- Udhëzime për punësim, vlerësim të nevojave, zhvillim të karrierës apo të profesionit metodika për punësim.
- 18- Pjesëmarrje në përmirësimin e tregut të punës nëpërmjet trajnimit dhe ndërhyrjeve në përmirësimin e legjislacionit të tregut të punës.
- 19- Shërbime ndërmjetësimi në të dy kahët për punëdhënësin por edhe për punëmarrësin, apo shërbime ndërmjetësimi të pa lidhura ngushtësisht me çështjet e vetëm punësimin, etj.
- 20- Shërbime për punëdhënësit, kryesisht informacion mbi tregun e punës, shërbime të ofrimit të kandidatëve të mundshëm për rekrutim në pune, informacion për programet e ndryshme të tregut të punës etj.
- 21- Shërbimet e migracionit në fushën e imigrimit edhe atë të emigrimit.
- 22- Procedura ligjore për pajisjen me leje pune, viza, leje qëndrimi për shtetasit e huaj në Republikën e Shqipërisë.
- 23- Referuar vetë subjekteve të mirëpërcaktuara në këtë ligj janë identifikuar të gjithë shtetasit e huaj që synojnë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë si qëllim tranzitimin, punësimin, studimin apo ripranimin. Këta të huaj trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë

Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të mësipërme, Shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo te dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Për përmbushjen e objektit të saj, Shoqëria mund të:

- a) Të zotërojë direkt ose indirekt pjesëmarrje në shoqëri dhe/ose sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose që mund të ndihmojnë në realizimin e objektit të Shoqërisë;
- b) Të themelojë degë, zyra përfaqësimi dhe në përgjithësi të kryejë çdo aktivitet tjetër që nuk është i ndaluar nga ligji.

**NENI 5**  
**KAPITALI I SHOQËRISË**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë “RECRUIT PLUS” Sh.p.k. është 100.000 (njëqind milion) Lekë.
2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është ne përputhje me kontributin e tyre, si më poshtë:
  - Ortaku Eljo Hysko zotëron një kuotë të barazvlefshme me 50% të kapitalit themeltar.
  - Ortaku Bardha Dyrmishi zotëron një kuotë të barazvlefshme me 50% të kapitalit themeltar.

Ky kapital është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Kuotat e Ortakëve regjistrohen në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

**NENI 6**  
**ORGANET E SHOQËRISË DHE ASAMBLEJA**

Organet drejtuese të shoqërisë “RECRUIT PLUS” Sh.p.k janë:

1. Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
2. Administratori i shoqërisë, Z. Arjan Ruçaj, i datëlindjes 28/08/1998, lindur në Fier dhe banues Tiranë, identifikuar me ID me Nr. 032807759 dhe Nr. Personal J80828079D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**NENI 7**

Të drejtat dhe detyrat e Asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj shprehen në statut i cili së bashku me aktin e themelimit përbëjnë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

**NENI 8**

Veprimtarinë e saj, shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

**NENI 9**

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore, zgjidhen me Ndërmjetësim me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat, atëhere zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "RECRUIT PLUS" Sh.p.k në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë. Në këtë ditë shoqëria "RECRUIT PLUS" Sh.p.k njihet si person juridik.

Ky akt themelimi u hartua në tre ekzemplarë me vlera të njëjta juridike dhe pasi iu lexua themeluesit, u nënshkrua rregullisht prej tij.

### ORTAKËT

**Eljo HYSKO**

Eljo Hysko



**Bardha DYRMISHI**

Bardha Dyrmishi

